

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e studimit Bsc në “Administrim Biznes”
Ofruar nga Universiteti Epoka

Ekspert i vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Vasilika Kume



(Korrik / 2017)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc në "Administrim Biznesi"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "EPOKA"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative
3	Urdhri/VKM i licencimit Urdhri i riorganizimit	VKM Nr. 281, datë 12.03.2008 Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012
4	Urdhri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr. 260, datë 07.06.2011 (Bsc Administrim Biznesi 4 vite) (*)
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Administrim Biznesi
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	Universiteti Epoka
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli i 6 (gjashtë)
16	Aktivizimi i programit të studimit	2012 - 2013
17	Numri i studentëve për program studimi	174

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

* Sipas Urdhërit të Akreditimit Nr. 260, datë 07.06.2011, ky program studimi është akredituar si; Bachelor në Administrim Biznesi **me kohëzgjatje normale 4 vite**. Është hera e parë që ky program studimi i nënshtohet procesit të akreditimit pas riorganizimit të tij me Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012, si Bsc në Administrim Biznesi **me kohëzgjatje normale 3 vite**.

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznes

Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi i Universitetit “Epoka” u licencua me Vendim Nr. 281, datë 12.03.2008, të Këshillit të Ministrave.

Më tej, në bazë të Urdhrit Nr. 260, datë 07.06.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, u përfundua me sukses procesi i akreditimit institucional dhe i programeve të studimit “Bachelor” të ofruara nga Universiteti “Epoka”, përfshirë edhe programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi.

Bazuar në urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 312, datë 27.07.2012, programi Bachelor në Administrim Biznesi me një kohëzgjatje normale të studimeve prej katër vitesh akademike (240 ECTS), u riorganizua në program Bachelor në Administrim Biznesi me një kohëzgjatje normale të studimeve prej tre vitesh akademike (180 ECTS).

Per programin e riorganizuar **Bsc Administrim Biznesi (3 vite)** nuk ka urdher akreditimi

Më 05.07.2017 me shkresë nr. 020/11 prot, Universiteti Epoka paraqet pranë ASCAL komente në lidhje me Draft - RVJ e dërguar në këtë institucion më datë 23.06.2017 me shkresë nr. 14/20 prot. Ekspertja e vlerësimit të jashtëm i pa me kujdes këto komente dhe merr në konsideratë vetëm komentin 2 duke reflektuar ndryshimet në raportin përfundimtar. Komentet e tjera nuk u konsideruan nga Ekspertja duke lënë të pa ndryshuar atë çka paraqitet në Draft - Raport.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. Dr. Vasilika Kume

Gjatë gjithë procedurës, ekspertja e jashtme e vlerësimit është asistuar nga specialisti i ASCAL Znj. Majlinda Demirneli.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e dhëna në VKA Nr. 176, datë 30.05.2011 nga Këshilli i Akreditimit

- a) Të harmonizohet më mirë sistemi amerikan i përdorur me atë evropian në kuadër të procesit të Bolonjës;
- b) Të zgjerohet kompletimi i bibliotekës me literaturë më të larmishme e me tirazh më të lartë;

- c) Të stimulohet më mirë puna individuale e studentit gjatë zhvillimit të procesit mësimor duke i dhënë përparësi orëve të veçanta të seminareve, prezantimeve me gojë, eseve të ndryshme, projekteve individuale e në grup etj;
- d) Të ketë një profilizim më të qartë të personelit akademik në fusha të caktuara në shërbim të rritjes së nivelit të mësimdhënies;
- e) Të koordinohet më mirë periudha e qëndrimit të profesorëve vizitues në mënyrë që të mos krijojmë mbingarkesa mësimore që vënë në vështirësi punën e studentëve.

Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin, *“Të harmonizohet më mirë sistemi amerikan i përdorur me atë evropian në kuadër të procesit të Bolonjës”*, institucioni ka riorganizuar programet tërësisht në përputhje me procesin e Bolonjës. Çdo lëndë është e bazuar në kredite (ECTS), e cila lejon programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesit për të zbatuar parimet e autonomisë dhe mobilitetit; Me riorganizimin e bërë në vitin 2012, programi Bachelor në Administrim Biznesi me një kohëzgjatje normale të studimeve prej katër vitesh akademike (240 ECTS), u riorganizua në program Bachelor në Administrim Biznesi me një kohëzgjatje normale të studimeve prej tre vitesh akademike (180 ECTS).
- b) Për rekomandimin, *“Të zgjerohet kompletimi i bibliotekës me literaturë më të larmishme e me tirazh më të lartë”*, nga vizita e bërë nga grupi i vlerësimit të jashtëm, u konstatua se biblioteka ishte pasuruar me tituj të rinj. Element i rëndësishëm që u konstatua ishte mundësia e aksesit të studentëve në tituj librash apo revistash online.
- c) Për rekomandimin, *“Të stimulohet më mirë puna individuale e studentit gjatë zhvillimit të procesit mësimor duke i dhënë përparësi orëve të veçanta të seminareve, prezantimeve me gojë, eseve të ndryshme, projekteve individuale e në grup etj”*, Institucioni vazhdimisht ka punuar në drejtim të aktivizimit dhe rritjes së pjesëmarrjes së studentëve, nëpërmjet metodave të ndryshme si projekte, punime kursi, case study etj. Grupi i vlerësimit të jashtëm u konsultua me syllabus-et e lëndëve dhe gjatë kontaktit me stafin akademik konstatoi se përdorshin metoda bashkëkohore të aktivizimit dhe pjesëmarrjes së studentëve.
- d) Për rekomandimin, *“Të ketë një profilizim më të qartë të personelit akademik në fusha të caktuara në shërbim të rritjes së nivelit të mësimdhënies”*, institucioni ka bërë hapa të rëndësishme në këtë drejtim. Grupi i vlerësimit të jashtëm është konsultuar me listë organikën e personelit akademik, syllabuset dhe orarin akademik dhe konstatoi se aktualisht numri i stafit me doktoraturë është rritur në këtë departament dhe lektorët janë të specializuar tashmë në tema të kufizuara.

e) Për rekomandimin, *“Të koordinohet më mirë periudha e qëndrimit të profesorëve vizitues në mënyrë që të mos krijojmë mbingarkesa mësimore që vënë në vështirësi punën e studentëve.”*, institucioni ka koordinuar më mirë periudhën e qëndrimit të profesorëve vizitues. Profesorët vizitues menaxhohen nga Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, departamenti i Administrimit të Biznesit dhe drejtpërdrejt nga profesori i interesuar i lëndës. Ky koordinim i trefishtë shmang si pasojë mbingarkesën dhe vështirësitë për studentët.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Grupit të vlerësimit të jashtëm ju vu në dispozicion dokumenti i strategjisë afatshkurtër dhe afatgjatë të Universitetit “Epoka”. Duke u mbështetur në Raportin e vlerësimit të Brendshëm, në dokumentin e strategjisë dhe bisedat me stafin akademik, GVJ konstatoi si më poshtë:

Programi i Studimeve Bachelor në Administrim Biznes i Universitetit “Epoka” ka si mision *pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme në fushën e menaxhimit si dhe të administrim biznesit, duke bërë të mundur kultivimin e sensit të intelektualizmit, bashkëpunimit dhe udhëheqjes (leadershipit) gjithëpërfshirëse, në mënyrë që ata të jenë punonjës të kualifikuar dhe të aftë që të shërbejnë si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.*

Ndërkohë vizioni i Departamentit të Administrim Biznesit, si pjesë integrale e Universitetit “Epoka”, është që të jetë një partner i vlefshëm në transformimin e rasteve të suksesit në fushën e biznesit, në mënyrë që pas çdo historie suksesi të jenë profesionistët e “Epoka”, të gatshëm për tregun.

Departamenti i Administrim Biznesit është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Në dokumentin e strategjisë së Universitetit, evidentuam se objektivat e programit bachelor në Administrim Biznes fokusohen në përgatitjen e individëve me aftësi profesionale dhe me një nivel të lartë të mendimit kritik. Mbi bazën e këtij dokumenti rezulton se objektivat e Programit: Bachelor në Administrim Biznesi janë si më poshtë

1. Mundësimi i përfitimit të aftësive praktike për të kuptuar, analizuar, shpjeguar dhe përdorur konceptet bazë të Administrimit të Biznesit

2. Mundësimi i përfitimit të aftësive praktike për të kuptuar kërkesat e dizajnit të një njësie ose mjedis biznesi
3. Mundësimi i përfitimit të njohurive mbi menaxhimin dhe organizatën, mbi marketingun dhe prodhimin, si dhe mbi kontabilitetin dhe financat.
4. Mundësimi i përfitimit të aftësive praktike për të përdorur metodat matematikore dhe statistikore në menaxhimin e biznesit
5. Mundësimi i përfitimit të aftësive të komunikimit përmes marrjes së terminologjisë profesionale të administrimit të biznesit
6. Mundësimi i të mësuarit dhe adoptimit të përgjegjësive etike, sociale dhe ligjore të nevojitur në fushën e administrimit dhe menaxhimit të biznesit
7. Mundësimi i përfitimit të aftësive të përdorimit efektiv të sistemeve të TIK-ut dhe metodave moderne në menaxhimin e biznesit
8. Mundësimi i përfitimit të njohurive teorike mbi teoritë klasike dhe moderne të menaxhimit të biznesit
9. Mundësimi i përfitimit të një sjellje me mendje të hapur përmes mësim-nxënies dhe praktikës së vazhdueshme, si dhe pjesëmarrjes

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të</p>	<p>Qëllimi dhe Misioni i Universitetit “Epoka”, dhe në këtë kuadër të Departamentit Administrim Biznesi janë të shprehura qartë në statutin e këtij institucioni. Gjithashtu dhe programi i studimit Administrim Biznesi është në përputhje me këtë qëllim dhe mision.</p> <p>Kurrikula e studimeve të këtij programi është në mbështetje të vetë objektivave të tij, për ti dhënë studentit një formim bazë, njohuri teorike dhe empirike mbi veprimtaritë e ndryshme të biznesit, të integrojë mësim-dhënien me kërkimin shkencor dhe së fundmi të zhvillojë praktikën.</p> <p>Mbështetur në objektivat e Departamentit AB,</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

<p>fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>(bazuar në dokumentin e strategjisë, pohimet e stafit dhe dokumentit RVB), programi synon kualifikimin e stafit të ri me njohuri të përgjithshme në lidhje me sfidat e ekonomisë, menaxhimit të biznesit, me synim punësimin në sektorët publik dhe privat brenda dhe jashtë vendit. Studenti do të jetë në gjendje të marrë njohuritë e nevojshme për të vepruar në Shqipëri dhe jashtë vendit duke mësuar: kuadrin teorik; ekonominë shqiptare dhe të huaj; ligjet përkatëse; bazat e menaxhimit.</p> <p>Në bisedat me stafin dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga përgjegjësi i departamentit, konkluduar se institucioni realizon në mënyrë periodike studime tregu për të parë se cilat janë nevojat e punës me qëllim përshtatjen e programeve e të studimit. Zyra planifikimit të Karrierës organizon në mënyrë periodike panairët e Karrierës, gjë që shërben, midis të tjerave edhe për evidentimin e nevojave të tregut të punës.</p> <p>Institucioni dëshmon dhe faktin se për të konkluduar me programet e ofruara të studimit janë mbështetur në konsulta me ekspertë të ekonomisë dhe kryesisht janë bazuar në studimin e tregut dhe rezultatet e mara prej tij. Politikat zhvillimore të departamentit hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës.</p> <p>GVJ ju vunë në dispozicion programi i studimit dhe syllabuset, ku u konstatua se temat e trajtuara janë në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka hartuar strategjinë e zhvillimit të Institucionit dhe të departamenteve. Grupi i vlerësimit të jashtëm u konsultua me dokumentin e strategjisë, “Plani strategjik për Krijimin e Vlerës, 2013-2017 dhe 2017-2022. Bazuar në planin strategjik të institucionit është hartuar Plani i Zhvillimit të Departamentit Administrim Biznes. Programi i studimit “Administrim</p>

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;

Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;

Biznesi" është në përputhje me këtë Strategji zhvillimi.

Duke u nisur nga kurrikula e ofruar në këtë program studimi, studentit i mundësohet të pajiset me njohuritë bazë, metoda e parime shkencore si dhe të fokusohet në përdorimin praktik të këtyre parimeve.

Bazuar në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit Bachelor, programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Administrim Biznesi pajis studentët me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare si dhe qasjet bashkëkohore që i strukturon lëndët me termat Sjellja Organizative, Menaxhim dhe Organizim, Marketing, Hyrje në Ekonomi, Hyrje në Kontabilitet etj. Programi në total ka 180 kredite në përputhje kjo me kornizën ligjore, gjithashtu dhe Planet Mësimore të ofruara janë në përshtatshmëri me nevojat dhe mundësitë e institucionit.

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;

Bazuar në strategjinë e Institucionit, ai synon programe studimi në përputhje me strategjitë e zhvillimit ekonomik Kombëtar. Një ndër objektivat në planin strategjik është përditësimi i programeve mësimore dhe kërkimi shkencor sipas nevojave të tregut.

Me synim kryesor plotësimin e nevojave të tregut të punës, institucioni ka ndërmarrë studime të tregut të punës të organizuar nga zyra e karrierës.

- a) Mbështetut në bisedat me stafin dhe studentët si dhe në evidencat e prezantuara, rezulton se studentët e Universiteti Epoka janë të punësuar në tregun vendas dhe atë rajonal, afërsisht 80 përqind.

<p>b. kërkesat e punëdhënësve;</p> <p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>b) Universiteti “Epoka” ka në organigramën e tij Zyrën e Karrierës dhe Alumni, nëpërmjet së cilave institucioni i ndjek studentët e tij deri disa vite pas përfundimit të studimeve të tyre. Institucioni zotëron një databazë të punësimit të studentëve.</p> <p>c) Sipas të dhënave të sekretarisë së institucionit regjistrimet në profilin Administrim Biznesi për tre vitet e fundit kanë qenë 30-40 studentë, numër që pritet të rritet në vitet e ardhshëm deri në 50 studentë.</p> <p>d) Lidhur me numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme, kuotat që ofron institucioni janë në nivele pak më të ulta. Duhet theksuar se nga konsultimi me dokumentat e sekretarisë mësimore, studentët e regjistruar kanë mesatare mbi 9-të.</p>
--	---

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi “Administrim Biznesi” i ofruar nga Universiteti “Epoka” ofrohet në pajtim të plotë të interesave kombëtare, mbështetur kjo në misionin që ky institucion ka, kurrikulën e studimeve dhe planin strategjik të tij.</p> <p>Duke iu referuar literaturës së përdorur, programeve të studimit, planit strategjik të institucionit si dhe politikës bashkëpunuese që ndiqet me studentët dhe stafin, Universiteti “Epoka” ndihmon në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare</p>
--	--

Konkluzione të GVJ:

GVJ konkludon se programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” është në përputhje me misionin e këtij institucioni si dhe me strategjinë e tij për zhvillim. GVJ konkludon se programi i ofruar është në përputhje me interesat kombëtare dhe me tregun e punës. Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.

Misioni i këtij programi është (referuar dokumentit të strategjisë): “Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi i pajis studentët me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare si dhe qasjet bashkëkohore për programe

ndërdisciplinore. Në këtë program studentët mësojnë konceptet bazë të fushës së administrim biznesit të cilat gjejnë aplikim në shumicën e hallkave të strukturës organizative/organigramës.”

Ajo cka vihej re ishte se deklaratat e misionit dhe vlerave të universitetit ishin afishuar në ambjentet e universitetit.

Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit dhe synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës. Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

Si konkluzion mund të themi administrimi i Departamentit Administrim Biznesi i Universitetit “Epoka”, bëhet plotësisht në funksion të programeve të studimit.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Universiteti “Epoka” përbëhet nga dy fakultete të cilët operojnë si njësi kryesore. Respektivisht, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Fakulteti është njësi kryesore e Universitetit “Epoka” i cili bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme, në përfundim të cilave përfitohet diplomë. Organet dhe autoritetet drejtuese të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative janë: dekani, zëvendës-dekani, kancelari, Bordi i Fakultetit dhe Bordi Administrativ të Fakultetit. Hapja, bashkimi ose mbyllja e fakulteteve në Universitetin “Epoka” bëhet me propozim të Senatit dhe me miratim të Këshillit të Lartë. Dekani është udhëheqësi kryesor i Fakultetit dhe emërohet me propozim të Rektorit dhe miratim të Këshillit të Lartë për një periudhë dyvjeçare me të drejtë rизgjedhjeje. Marrëdhëniet me Kompaninë Themeluese përcaktohen në kontratën e punësimit. Dekanët duhet të kenë titullin shkencor “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose “Doktor”. Bordi i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës që përcakton veprimtarinë e planifikuar të mësimdhënies dhe fushës kërkimore të Fakultetit në bazë të propozimeve të departamenteve. Bordi i Fakultetit përbëhet nga Dekani, i cili drejton bordin, përgjegjësit e departamenteve, drejtorët e qendrave kërkimore të zhvillimit, si dhe një anëtar i stafit akademik për secilin departament. Kancelari i Fakultetit ka për detyrë raportimin në takimet e Bordit të Fakultetit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit

Duke u bazuar në Ligjin “Mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar me ligjin nr. 10307, datë 22.07.2010 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në licencën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave në mars 2008 Organizimi i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative në Universitetin “Epoka” është si më poshtë:

- Departamenti i Ekonomiksit;
- Departamenti i Financë-Bankës;
- Departamenti i Administrim Biznesit;
- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;

Dekani është drejtuesi kryesor i fakultetit. Dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative, Z. Salih ÖZCAN mban titullin ‘Prof Asoc. Dr.’ Midis të tjerave, dekani drejton dhe kontrollon gjithë punën mësimore dhe shkencore të Fakultetit, siguron zbatimin e planeve dhe programeve mësimore dhe kalendarit akademik të Fakultetit si dhe Interpreton dhe zbaton politikën e zhvillimit në Fakultetin përkatës;

Zv/Dekani është në mesin e autoriteteve udhëheqëse të Fakultetit. Zv/Dekani duhet të ketë së paku gradën "Doktor". Ai propozohet nga Dekani dhe emërohet nga Rektori për një kohëzgjatje dyvjeçare. Zv. Dekani organizon punën shkencore-mësimore në Fakultet, ndjek zbatimin e planeve dhe programeve të studimeve të cikleve të ndryshme si dhe harton kalendarin e procesit të mësimdhënies.

Bordi i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës që përcakton veprimtarinë e planifikuar të mësimdhënies dhe fushës kërkimore të Fakultetit në bazë të propozimeve të departamenteve. Bordi i Fakultetit përbëhet nga Dekani, i cili drejton bordin, përgjegjësit e departamenteve, drejtorët e qendrave kërkimore të zhvillimit, si dhe një anëtar i stafit akademik për secilin departament. Kohëzgjatja e Bordit të Fakultetit është dy vjet. Bordi i Fakultetit ka disa kompetenca. Ai vendos mbi aktivitetet e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe publikimeve të Fakultetit; përcakton parimet, planet, programet, tekstet për studentët dhe përdorimin e kalendarit akademik në lidhje me aktivitete të tilla.

Kancelari i Fakultetit ka për detyrë raportimin në takimet e Bordit të Fakultetit.

Bordi i Administrimit të Fakultetit, është organ kolegjal vendimmarrës, që programon e përcakton në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit. Bordi i Administrimit të Fakultetit përbëhet nga dekani, i cili e kryeson, dhe nga të paktën katër anëtarë të stafit akademik të zgjedhur për një mandat dyvjeçar nga Bordi i Fakultetit, duke marrë në konsideratë titujt e tyre akademikë. Bordi i

Administrimit të Fakultetit ka disa kompetenca: Ai ndihmon dekanin për zbatimin e vendimeve të Bordit të Fakultetit, siguron zbatimin e planeve dhe të programeve të mësimdhënies, si edhe të kalendarit akademik të fakultetit, merr vendime në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me administrimin e fakultetit, etj.

Këshilli i Profesorëve (KP) përbëhet nga të gjithë profesorët, me kohë të plotë, të Fakultetit. Lista e anëtarëve të Këshillit të Profesorëve hartohet dhe përditësohet nga Dekani i Fakultetit. Këshilli i Profesorëve drejtohet nga Kryetari i KP. Kryetari zgjidhet me votim të fshehtë të anëtarëve. Drejtimi i Këshillit të Profesorëve bëhet me rotacion për një vit akademik. Kandidaturat për kryetar propozohen nga një ose më shumë anëtarë. Procedura e zgjedhjes së Kryetarit të Këshillit të Profesorëve organizohet dhe drejtohet nga kryetari në detyrë. Drejtuesi i KP zgjidhet nga i gjithë Këshilli i Profesorëve duke siguruar 50%+1 të votave.

Departamenti është njësi bazë mësimore - kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse. Hapja, shkrirja ose mbyllja e departamenteve në Universitetin "Epoka" bëhet me propozim të Senatit dhe me miratim të Këshillit të Lartë. Departamenti ka disa kompetenca: Ai nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, kërkimit apo aktiviteteve artistike, duke respektuar liritë e personelit akademik dhe të drejtën për të shfrytëzuar materialin dhe burimet financiare në dispozicion të departamentit; shqyrton planet mësimore dhe i propozon Bordit të Fakultetit ndryshimet e përshtatshme; rishikon programin mësimor, i bën ndryshimet e nevojshme dhe ia propozon ato Bordit të Fakultetit; i propozon Bordit të Fakultetit tekstet të cilat do të përdoren nga studentët; kontrollon cilësinë e mësimdhënies; përcakton temat e punës shkencore dhe kontrollon zbatimin e tyre; drejton kualifikimin shkencor pasuniversitar afatshkurtër dhe afatgjatë; është i organizuar në mësimdhënie dhe grupe kërkimore me karakter të përkohshëm.

Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti më i lartë i njësisë bazë mësimore-kërkimore. Përgjegjësi i Departamentit zgjidhet nga Dekani mes anëtarëve të brendshëm të stafit akademik të Departamentit, miratohet nga Rektori dhe emërohet me vendim të Këshillit të Lartë për një periudhë dyvjeçare me të drejtë rizgjedhje. Përgjegjësi i Departamentit është përgjegjës për veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore në çdo nivel të departamentit dhe për drejtimin e rregullt dhe efikas të çdo aktiviteti brenda tij.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga vizita në institucion GVJ kërkoi dhe ju ofrua i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe i kërkuar në lidhje me organizimin e këtij institucioni. Disa nga dokumentat që na u ofruan ishin, organigrama e Universitetit, lista e evidencave të stafit pedagogjik, statusi dhe rregulloret e funksionimit të bordeve dhe departamenteve, listat e anëtarëve të bordit, CV-të e stafit drejtues, kontratat e punësimit për stafin e angazhuar me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme,

shpërndarja e stafit sipas titujve dhe gradave shkencore dhe sipas moshës, plani strategjik 2013-2017, etj.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Nga vizita në institucion e GVJ u morën të dhëna lidhur me stafin akademik dhe administrativ të Universitetit “Epoka”. Programi “Bachelor në Administrim Biznesi” bën pjesë në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative dhe si njësi bazë në Departamentin e Administrim Biznesit. Stafi akademik i angazhuar në këtë program përbëhet prej **15** (pesëmbëdhjetë) pedagogësh efektivë dhe prej **13** (trembëdhjetë) pedagogësh pjesëtarë të stafit akademik me kontratë. Të dhënat lidhur me stafin akademik Efektiv dhe me Kontratë, titujt dhe gradat shkencore si dhe raporti midis PAE dhe PAK janë paraqitur në Tabelat 1, 2 dhe 3 në fund të raportit.

Shpërndarja e ngarkesës së stafit akademik bëhet në fillim të vitit akademik ku ngarkesa mesatare shkon 320-350 orë në vit. Ndërkohe u konstatua që stafi përveç procesit të mësimdhënies angazhohej dhe në detyra administrative.

Kriteret e rekrutimit u konstatuan të jenë mjaft rigorozë dhe procedura e hapjes së një vendi të ri origjinohej nga nevojat e mundshme të departamenteve. Kriteret e rekrutimit të personelit akademik janë në varësi të kërkesës për staf akademik. Preferohen për t’u zgjedhur stafi akademik me grada e tituj. Nga këta, më të preferuarit janë ata të diplomuar në vende të zhvilluara. Rëndësi i jepet edhe përvojës së stafit që pritet të merret në punë. Në lidhje me punësimin e stafit akademik, Zyra e Financës përgatit kontratën e punës. Pas leximit të kontratës, stafi akademik e nënshkruan atë dhe Zyra e Financës siguron nënshkrimin e kontratës nga Rektori i Universitetit “Epoka” si edhe vulosjen e saj. Mbledhja e të dhënave të stafit bëhet nga një formë e cila quhet “Të dhënat individuale të stafit” ku çdo personel i ri hedh të dhënat e tij personale. Kjo formë qëndron në dosjen personale të çdo pjesëtari të stafit dhe të dhënat e tij gjithashtu hidhen në sistemin e Universitetit (EIS) me akses vetëm nga Zyra e Burimeve Njerëzore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit

Organizimi i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative në Universitetin “Epoka” është si më poshtë:

- Departamenti i Ekonomiksit;
- Departamenti i Financë-Bankës;
- Departamenti i Administrim Biznesit;
- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Aneks 1, Aneks 2)

Sipas të dhënave të mara në institucion mund të llogarisim se:

raporti PAE/PAK në këtë program studimi është $15/13 = 1.15$,

raporti Personel akademik / Personel Administrativ është $28/4 = 7$,

raporti Personel Akademik/student është $28/118^2 = 0.27$

raporti Personel Administrativ/student është $4/118 = 0.03$.

Raportet e dhëna më sipër janë mëse të mjaftueshme për numrin e studentëve aktualë të këtij programi.

Ngarkesa mësimore në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi në semestrin e vjeshtës për vitin akademik 2016-2017, për pedagogët më e kohë të plotë dhe kohë të pjesshme ishte si më poshtë:

1- Pedagogët më e kohë të plotë – 76 % të ngarkesës mësimore;

2- Pedagogët më e kohë të pjesshme – 24 % të ngarkesës mësimore.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre (Aneks 3)

Nga vizita e GVJ në institucion u konstatuan të dhënat e pasqyruara në Tabelën 3, në fund të këtij raporti. Mbledhja e të dhënave të stafit bëhet nga një formë e cila quhet “Të dhënat individuale të stafit” ku çdo personel i ri hedh të dhënat e tij personale. Kjo formë qëndron në dosjen personale të çdo pjesëtari të stafit dhe të dhënat e tij gjithashtu hidhen në sistemin e Universitetit (EIS) me akses vetëm nga Zyra e Burimeve Njerëzore.

- Të dhënat sipas seksit

Nga përbërja gjinore u konstatua se stafi mësimdhënës me kohë të plotë përbëhet nga 8 femra dhe 9 meshkuj.

- Të dhëna sipas moshës së personelit

Sipas moshës së personelit të brendshëm konstatohet shpërndarja si më poshtë:

Mosha	25-40	36-45	Mbi 45
Stafi	12	6	3

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

U konstatua një rigorozitet në mbajtjen dhe dokumentimin e të gjithë kontratave të punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Ekzistonin kontrata për staf të brendshëm si dhe për staf të jashtëm. Stafi i brendshëm pa titull akademik nënshkruan kontrata 1-vjeçare të rinovueshme në çdo vit akademik. Në to përshkruhen në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrat që

² Ky është numri i studentëve të regjistruar në vitet akademike 2014 - 2016

ka secili staf për mbarëvajtjen e punëve. Këto të drejta janë në përputhje me statutin dhe rregulloret e universitetit. I gjithë dokumentacioni lidhur me angazhimin e punonjësve, të brendshëm apo të jashtëm ishte në Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës administrativ funksiononte në nivel institucioni dhe duke u përshkallëzuar deri në nivel Departamenti. Departamenti kishte 1 koordinatorë dhe 2 specialiste në sekretarinë mësimore.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga vizita e GVJ në institucion u panë dokumenta të ndryshëm lidhur me personelin akademik dhe atë administrativ, si më poshtë:

- Kontrata pune për personel të brendshëm
- Kontrata pune për personel të jashtëm
- Listë prezencë e stafit
- Orët e angazhimit të stafit sipas detyrave të ndryshme, mësimdhënëse dhe administrative.
- Ngarkesa mësimore full time dhe part time

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p>	<p>Institucioni e bazon rekrutimin e stafit të ri mbështetur në një rregullore të qartë rekrutimi. Nevojat për staf të ri origjinohen nga Departamenti dhe përshkallëzohen në instancat më sipër. Njoftimet për vende të lira pune vendosen në faqen web të institucionit. Më pas një komision i ngritur nga institucioni zhvillon intervistën dhe vlerëson kandidatët. Nëse merret vendimi për punësimin e një kandidati të caktuar, ky vendim i shkon Bordit Administrativ të Universitetit. Bordi Administrativ i Universitetit pasi e shqyrton vendimin, ia transmeton atë Këshillit të Lartë të Universitetit i cili jep vendimin përfundimtar. Pas vendimit përfundimtar nga ana e Këshillit të Lartë të Universitetit, kandidati plotëson dokumentat e kërkuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe nënshkruan kontratën e tij pas</p>

<p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>deklarimit në organet tatimore.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në programin “Bachelor në Administrim Biznesi” përbëhet prej 15 (pesëmbëdhjetë) pjestarësh me kohë të plotë dhe 13 (trembëdhjetë) pjestarësh me kohë të pjesshme. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë angazhohet në 71% të totalit të orëve të këtij programi.</p> <p>Institucioni përdor disa metoda për vlerësimin periodik të stafit të tij. Së pari përdor pyetësorët e zhvilluar me studentët ku një nga pikat vlerëson dhe performancën e lektorit/asistentit. Informacioni i marrë nga ky pyetësor përpunohet dhe është subjekt i analizës së punës së përvitshme. Pyetësori zhvillohet dy herë në vit, dy javë përpara përfundimit të semestrit dhe menaxhohet nga zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Rezultatet e pyetësorit janë të disponueshme për përgjegjësin e departamentit dhe për çdo pedagog që vlerësohet në llogarinë e tij në web. Një mënyrë tjetër vlerësimi është ai që shefi i Departamentit bën për anëtarët e stafit të tij. Gjithashtu pjesë e vlerësimit është dhe formulari i vetëvlerësimit të stafit.</p> <p>Nga vizita që GVJ bëri në zyrën e burimeve njerëzore u konstatua se Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj. Raportet e rekrutimit të personelit bashkë me dokumentat e dërguara prej tyre ruhen nga ana e Zyrës së Burimeve Njerëzore në bazën e të dhënave të Zyrës së Burimeve Njerëzore në mënyrë konfidenciale. Forma më e përhapur e njoftimeve për vende të lira pune pranë Universitetit “Epoka” është nëpërmjet publikimit të këtyre njoftimeve në faqen e internetit të Zyrës së Burimeve Njerëzore në faqen e internetit të vetë Universitetit “Epoka”. Gjithashtu bashkëpunohet me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit të Tiranës për vende pune të lira pranë Universitetit “Epoka”.</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët</p>	<p>Baza e të dhënave lidhur me stafin akademik ndodhet në Zyrat e Burimeve Njerëzore.</p>

<p>e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor”, ose titullin akademik “Docent”.</p>	<p>Personeli i kësaj zyre është direkt përgjegjës për ruajtjen dhe mbledhjen e këtij informacioni. Pas përfundimit të procesit të punësimit të personelit akademik, Zyra e Burimeve Njerëzore hedh në sistemin interaktiv të Universitetit (EIS) të gjithë të dhënat e stafit akademik duke filluar nga ato personale si datëlindje, vendlindje, arsimimi gjithashtu duke hedhur në sistem edhe detyrat e ndryshme që stafi akademik mban pranë Universitetit “Epoka”, lejet që stafi akademik merr gjatë vitit akademik. <i>Mungesa e njohjes së gjuhës shqipe nga një pjesë e stafit të huaj mund të konsiderohet si një kufizim i tyre lidhur me ndjekjen e rregullt të zhvillimeve sociale, ekonomike dhe politike në vend.</i></p> <p>Lista e plotë e personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ ndodhet pranë kësaj zyre. Gjithashtu kjo zyrë disponon të gjitha kontratat e punësimit të stafit. Në kontrata specifikohen qartë të gjithë kushtet e punës, detyrimet dhe të drejtat e punonjësve. Në rastet e nevojës për personel të ri akademik apo administrativ, institucioni publikon në web site lajmërimin përkatës.</p> <p>Universiteti “Epoka” ka angazhuar si titullarë të lëndëve për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor”. Në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor të arsimit të lartë në fuqi, titullarët e lëndëve që nuk kanë gradën shkencore “Doktor”, kanë përfunduar programet e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave ose programe të barasvlefshme me to dhe njëkohësisht, vijojnë studimet e doktoraturës.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për</p>	<p>Universiteti “Epoka” angazhon asistentët kërkimorë si personel ndihmës kërkimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike</p>

<p>mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>dhe mirë-përdorimin e ambienteve laboratorike që ndodhen në mjediset shkollore.</p> <p>Vihet re një angazhim i stafit në disa drejtime. Ka raste që ata mbulojnë dhe mësimdhënie dhe punë administrative. Ndërkohë që departamenti ka koordinatoren e tij.</p> <p>Nga verifikimet që bëri GVJ, nga bisedat me studentët dhe stafin akademik, konkludoi që vendoset një tutor për një grup mësimor. <i>Praktikat profesionale ishin me dëshirë të studentit.</i> Përgjithësisht studentët ishin tejet të interesuar për praktika profesionale, gjë që realizohej me ndihmën e stafit dhe zyrës së karrierës.</p>
--	--

Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Universiteti “Epoka” në përputhje me kërkesat e statutit, rregulloreve të institucionit, dhe procedurave përkatëse, organizon në mënyrë të vazhdueshme trajnime në fusha të ndryshme për stafin akademik, stafin mësimor-shkencor si dhe stafin administrativ. Gjithashtu stafi trajnohet herë pas here edhe nga lektorë të huaj. Është traditë e institucionit zhvillimi i Lektoriumeve të hapura me lektorë shqiptarë dhe të huaj.</p> <p>Nga vizita në Universitetin. “Epoka” u konstatua se institucioni disponon një bazë të mirë të të dhënave për programet e ofruara.</p>
---	--

Konkluzione të GVJ:

GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se procedurat e rekrutimit janë transparente. Angazhimi i stafit është në disa drejtime. Njësia e burimeve njerëzore disponon një bazë të mirë të dhënash për të gjithë stafin ku gjithsecili ka kontratën përkatëse për punën që zhvillon. Personeli ndihmës (sekretaria) ishte në nivel universiteti dhe përshkallëzohej deri në nivel Departamenti.

Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit. Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij, dhe njëkohësisht angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij. Universiteti “Epoka”, angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.

Kriteret e rekrutimit u konstatuan të jenë mjaft rigorozë dhe procedura e hapjes së një vendi të ri origjinohej nga nevojat e mundshme të departamenteve.

Nga informacioni i marrë në disa drejtime, u konstatua një manaxhim korrekt me eksperiencë dhe i përkushtuar dhe staf akademik me kualifikim dhe përvojë ndërkombëtare;

Një pikë e dobët, që mendohet se mund të ndikojë disi në mësimdhënien është diversiteti kulturor i personelit akademik, megjithëse kjo pikë konsiderohet e tejkaluar për shkak të kohës së gjatë dhe adaptimit me mjedisin të pedagogëve të huaj.

Nga ana tjetër, mungesa e njohjes së gjuhës shqipe nga një pjesë e stafit të huaj mund të konsiderohet si një kufizim i tyre lidhur me ndjekjen e rregullt të zhvillimeve sociale, ekonomike dhe politike në vend.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Universiteti “Epoka”, për realizimin e funksioneve mësimdhënëse, administrative, kërkimore shkencore, etj. disponon një kampus dhe disa godina ofrojnë hapësira të mjaftueshme si, salla mësimi, laboratorë, bibliotekë, sekretari, zyra pedagogësh, etj. Kampusi qendror i Rinasit shtrihet në një sipërfaqe totale prej 67.000 m². Viti akademik 2016 -2017 po zhvillohet rregullisht në ambientet e 2 godinave të përfunduara me një sipërfaqe totale prej 14352 m². Kjo godinë ka një infrastrukturë moderne dhe një sistem qendror ngrohje-ftohje. Klasat janë të pajisura me videoprojektorë dhe me tabela inteligjente të cilat bëjnë të mundur zhvillimin normal të procesit mësimor. Në RVB është paraqitur dhe planimetria e kampuseve a cila nga vizita e GVJ rezultoi të jetë e njëjtë. Gjithashtu, në ambientet e godinës ‘Objekti Social Kulturor’ është në ndërtim e sipër një sallë konferencash me një sipërfaqe rreth 400 m² dhe kapacitet prej 300 personash. Biblioteka ka një sallë leximi me një kapacitet prej 70 vendesh.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

• Salla për leksione	4
• Klasa për seminare	16
• Salla për aktivitete promovuese	1
• Salla për praktikë lëndore/ profesionale	2
• Laboratorë për lëndët	2
• Laboratorë informatike	2
• Salla interneti	2
• Salla për bibliotekë	1
• Mjedis për fotokopjime, librari etj.	1
• Zyrë informacioni për studentët	1
• Nyje hidrosanitare	52

Mjediset për stafin:

• Mjedise për Dekanin/ kancelarin	4/1
• Zyra për sekretarinë mësimore	1

- Zyra për departamentet/qendrat kërkimore 10
- Zyra për personelin akademik 40

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

GVJ vizitoi ambientet e Universitetit “Epoka” dhe konstatoi se mjediset që sigurojnë mësimdhënien dhe punën shkencore si të stafit ashtu edhe të studentëve ishin optimale. U verifikua nëse deklaratimet e GVB ishin reale, dhe rezultoi se nuk kishte ndryshime midis faktit dhe raportimit. Pranë institucionit na u ofruan dhe planimetria e godinave përbërëse të Universitetit “Epoka”. Ato janë të paraqitura në RVB dhe nuk kanë ndryshime nga ajo çka është dokumentuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka vënë në dispozicion të studentëve një numër të konsiderueshëm tekstesh bazë dhe literature ndihmëse e cila gjendet në mjediset e bibliotekës së Universitetit. Kjo literaturë është bashkëkohore dhe pasqyrohet në silabuset përkatëse të secilës lëndë mësimore. Duke u bazuar tek kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë pasurohet në mënyrë periodike dhe vendoset në shërbim të studentëve. <i>Mund të përmendim këtu mungesën fizike të teksteve mësimore në bibliotekë.</i></p> <p>GVJ vizitoi ambientet e bibliotekës dhe konstatoi se biblioteka gjendet në katin e parë të godinës A në kampusin e universitetit dhe ka një sipërfaqe prej 400 metra katror dhe një sallë leximi me një kapacitet prej 70 vendesh. Biblioteka ka një fond të pasur me libra për degët përkatëse. Librat janë të inventarizuar dhe të ndarë sipas fushave dhe tematikës. Librat janë në gjuhë të ndryshme: shqip, anglisht, frëngjisht, turqisht dhe gjuhë të tjera.</p> <p>Universiteti “Epoka” për të ofruar tek studentet e tij një shërbim të shpejtë dhe për të rritur transparencën ka vënë në zbatim disa shërbime siç janë: webmail, Epoka Interactive System (EIS), Education Information System</p>

<p>të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>(Curriculum), Learning Management System (LMS), Google Classroom, Library Automation System, Dspace, Faqet e internetit të Universitetit dhe Departamenteve.</p> <p>Shtimi i bazës materiale të bibliotekës vjen nga vetë institucioni duke marrë në konsideratë sugjerimet dhe nevojat e stafit. Para fillimit të çdo viti akademik, përgjegjësi i programit të studimit harton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit duke përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim. Fondi i bibliotekës pasurohet edhe nga donacionet e stafit apo të të tretëve.</p> <p>Oraret e punës të bibliotekës janë të shpallura në faqen Web të Universitetit. Ato janë të shfaqura edhe në hyrje të bibliotekës, e cila është e hapur për studentët nga e hëna deri të premten nga ora 08:30 deri në 17:30 dhe të shtunën nga ora 09:00 deri në 13:00.</p>
--	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga të dhënat e ofruara në lidhje me numrin e studentëve dhe të stafit, GVJ arriti në përfundimin se hapësirat e ofruara nga Universiteti “Epoka” janë të mjaftueshme për zhvillimin korrekt të veprimtarisë së këtij institucioni .</p> <p>Nga GVJ u konstatua se shërbimet në sektorin e shëndetit, ushqimit dhe aktiviteteve sportive për studentët janë disi të kufizuara.</p> <p>Klasat dhe auditorët janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e një procesi mësimor sa më efektiv. Gjithashtu, mjediset janë të kompletuara me sistem kondicionimi, kompjuter, projektor, tabelë interaktive (smart board), internet, karrige ortopedike etj.</p> <p>Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Për të përmbushur nevojat e programeve të studimit, janë ngritur dy salla për seminarët e arkitekturës, dy laboratorë kompjuterikë, një laborator elektronike dhe laborator i Inxhinierisë së Ndërtimit.</p>
---	--

programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhinieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj.

Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

Për të bërë të mundur një mësimdhënie sa më efektive dhe për t'u ardhur në ndihmë studentëve, universiteti ka instaluar një gamë të madhe programesh kompjuterike

Kriteri 6

Institucioni i mundëson studentëve e tij zhvillimin e praktikave mësimore në biznese të ndryshme. Bazuar në marrëveshjet që Universiteti "Epoka" disponon me institucione të tjera apo biznese private ai është në gjendje të përballojë praktikën profesionale si një pjesë suplementare të programit të studimit.

Për studentët e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative me anë të marrëveshjeve të veçanta mundësohen praktika pothuajse pranë të gjithë bankave të nivelit të dytë si dhe pranë bizneseve që ofrojnë kushtet dhe hapësirat e mjaftueshme për praktika mësimore si brenda vendit ashtu edhe jashtë. Për shkak të natyrës së programit, studentët e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi përfitojnë nga mundësitë e praktikave mësimore që i ofrohen Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative. *Studentët në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi nuk e kanë të detyruar kryerjen e praktikës profesionale.*

Konkluzione të GVJ:

GVJ, nga vizita në Universitetin "Epoka", konstatoi se mjediset e ofruara janë të përshtatshme dhe tepër moderne për procesin mësimor, administrativ, kërkimor e shkencor të institucionit.

Gjithashtu institucioni ofron një bibliotekë për nevojat e studentëve dhe të stafit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij, laboratorë dhe mjedisë të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

Universiteti "Epoka" është i abonuar në bazën e të dhënave JSTOR e cila i mundëson stafit dhe studentëve të Universitetit aksesin në një gamë mjaft të gjerë të revistave shkencore. Përmes këtij fondi online, aksesin në mbi 2000 revista akademike të burimeve elektronike me tekst të plotë me cilësi të lartë është i disponueshëm pa pagesë për stafin, studentët dhe përdoruesit e bibliotekës. Burime të tjera elektronike të mundësuar për stafin dhe studentet janë: Cambridge Journals Online, IOPscience, New England Journal of Medicine, OEc-iLibrary, Taylor & Francis Library. Ky fond i pasur i botimeve periodike dhe bibliotekës elektronike i ofron studentëve të programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi të gjitha mundësitë për përmbushjen me sukses të kërkesave të programit të studimit si dhe për kryerjen e hulumtimeve të ndryshme në lidhje me përgatitjen e detyrave, projekteve, temave të diplomimit si

dhe të punimeve të tjera individuale.

Sistemet e informacionit dhe faqja web janë shumë funksionale dhe mjaft informuese si për stafin aktual ashtu edhe për studentët potencialë;

Mund të përmendim këtu mungesën fizike të teksteve mësimore në bibliotekë.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Universiteti Epoka arkëton të ardhura nëpërmjet shërbimeve të ofruara. Të ardhurat e saj vijnë nga tarifat e shkollimit që japin studentët e këtij institucioni. Institucioni disponon një Zyrë finance me staf përgjegjës për mbarëvajtjen financiare të tij. Institucioni i nënshtrohet auditimit si dhe kontrollit nga organet tatimore. Drejtoria e Përgjithshme e Turgut Ozal Education sh.a., pjesë e së cilës Universiteti “Epoka” është, si dhe Zyra e Financës e Universitetit EPOKA në bashkëpunim me njëra-tjetrën bashkërendojnë çështjet financiare dhe menaxhuese.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim -
- Konsulencat, shërbimet -
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit 94%
- Sponsorizimet -
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) -
- Donacionet, aktivitetet siguruuese, fondacione etj -
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, rezidencat, etj) 6%

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Pjesa më e madhe e të ardhurave nga pagesat e studentëve shkon për shpenzime në lidhje me tarifat për dhe gjatë shkollimit. Nga shqyrtimi financiar i kryer nga vetë Universiteti “EPOKA” rezulton se të ardhurat mesatare për student për vitin akademik 2015-2016 janë 1.846 euro, ndërsa shpenzimet mesatare për student për vitin akademik 2015-2016 janë 1.342 euro.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion u shqyrtuan pasqyrat financiare dhe bilancet dhe nuk u konstatuan ndryshime lidhur me tabelat financiare të pasqyruara në RVB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni i nënshtrohet një auditit të përvitshëm.</p> <p>Në përbërje të këtij raporti auditit përfshihen pagat e të gjithë punonjësve, shpenzimet e institucionit, detyrimet, pagesa, të ardhurat, etj. Të hyrat dhe të dalat financiare të Turgut Ozal Education sh.a kontrollohen në mënyrë të rregullt nga institucionet kompetente shtetërore. Përveç kësaj, çdo vit institucioni auditohet nga kompani audituese të jashtme. Raportet e hollësishme të këtyre auditëve ju vunë në dispozicion GVJ nga Zyra e Financës.</p> <p>Raporti i auditimit është i detajuar dhe përmban çdo zë. Në tre vitet e fundit nuk dokumentohet të ketë grante të huaja të fituara.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme</p>	<p>Të gjitha të ardhurat nga tarifat e shkollimit si dhe kontributet e tjera financiare pasqyrohen në raportet financiare të përvitshme të Universitetit "Epoka".</p> <p>Zyra e financës disponon gjithë materialin e dokumentuar të viteve të fundit të aktivitetit të institucionit.</p> <p>Sipas raporteve financiare të tre viteve të fundit të Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a, kompania ka një bilanc vjetor pozitiv, i cili garanton ecurinë e</p>

në të ardhmen.	<p>Universitetit “Epoka”.</p> <p>Megjithatë, për shkak të numrit të kufizuar të studentëve dhe investimeve të bëra në ambiente e universitetit, mund të themi (gjë që reflektohet edhe në RBV), <i>burimet financiare janë të kufizuara.</i></p>
<p><u>Konkluzione të GVJ:</u></p> <p>Institucioni në mënyrë periodike vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare me anë të Zyrës së Financës. Gjithashtu ai auditohet dhe është nën kontroll të organeve tatimore. Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare dhe harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p> <p>Për shkak të numrit të kufizuar të studentëve dhe investimeve të bëra në ambiente e universitetit, mund të themi (gjë që reflektohet edhe në RBV), <i>burimet financiare janë të kufizuara.</i></p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkimore

Në përputhje të plotë me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar dhe Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit “Epoka”, institucioni ka ngritur një Njësi të Sigurimit të Cilësisë e cila funksionon në bazë të “Rregullores së Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë” miratuar me vendim të Senatit Akademik. Rregullorja shpreh qartë rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet së cilës garantohet cilësia gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të Universitetit. Ngritja dhe funksionimi i këtij sistemi rregullohet hollësisht nëpërmjet Udhëzimit “Për vlerësimin akademik dhe përmirësimin e cilësisë në Universitetin “Epoka”. Ky udhëzim rregullon procesin e vlerësimit të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe të çdo shërbimi në Universitetin “Epoka”, zhvillimin e cilësisë, ngritjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, aplikimin, zhvillimin dhe vlerësimin e tij, miratimin e treguesve të cilësisë në kuadër të periudhës së vlerësimit të jashtëm si dhe kryerjen e të gjitha përgatitjeve të nevojshme gjatë këtij procesi.

Në janar 2010, Universiteti “Epoka” është pajisur me certifikatën ISO 9001:2008 për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë. Aktualisht, Universiteti “Epoka” e ka ripërtërirë këtë certifikatë, e cila sipas kriterëve të ISO-s kryhet çdo tre vjet. Kontrolli i fundit i jashtëm është bërë në mars 2014. Për të mbikëqyrur zbatimin korrekt të të gjitha proceseve dhe procedurave të punës të parashikuara sipas standardit ISO, në Universitetin “Epoka” ngrihet edhe Grupi i Auditit të

Brendshëm, i cili nëpërmjet kryerjes së auditimeve periodike siguron zbatimin e proceseve dhe procedurave në fjalë në institucion dy herë në vit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

GVJ konstatoi se parimet mbi të cilat ndërtohet Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë janë: krijimi i një tabloje të qartë dhe reale rreth gjendjes aktuale të Universitetit “Epoka” në momentin e dhënë; ngritja e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe krijimi i kulturës së cilësisë në institucion; si edhe garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën UMB, njësive të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj. Objektivat e NJBSC janë: monitorimi i vazhdueshëm i drejtimit të institucionit; ndjekja e vazhdueshme e programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre; ndjekja e vazhdueshme e nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij. Në përfundim të çdo semestri akademik, të gjithë **studentët e Universitetit “Epoka” plotësojnë nëpërmjet sistemit elektronik pyetësorët** në lidhje me vlerësimin e pedagogut për çdo lëndë. Përmbajtja e pyetësorëve është standarde dhe konsiston në vlerësimin nga ana e studentit të 14 përbërësve me një interval nga 1 (vlerësimi më i ulët) deri në 4 (vlerësimi më i lartë). Një kopje e pyetësorit gjendet bashkëngjitur. Plotësimi i pyetësorit bëhet në mënyrë krejtësisht konfidenciale dhe çdo student është i detyruar të plotësojë pyetësorin në mënyrë që të ketë mundësi të shohë në sistemin elektronik notën përfundimtare të marrë në lëndën përkatëse.

Rezultatet e pyetësorëve i përcillen Rektoratit nga Sekretaria Mësimore. Rektori, pasi shqyrton rezultatet e pyetësorëve, ia përcjell ato KVAZHC-së, i cili kryen analizimin e të dhënave për çdo lëndë dhe pedagog dhe del me rekomandimet përkatëse për Rektoren. Nëpërmjet mbledhjeve të Senatit, Rektori siguron që rekomandimet e KVAZHC-së në lidhje me përmirësimin e procesit të mësimdhënies të zbatohen në nivel Fakulteti dhe Departamenti.

Në përfundim të çdo semestri akademik, KVAZHC kryen një **analizë sasiore dhe cilësore të rezultateve të studentëve** dhe del me rekomandimet përkatëse, me një theks të veçantë në evidentimin e problematikave dhe të fushave që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Një metodë mjaft efikase për të mbikëqyrur cilësinë e mësimdhënies në Universitetin “Epoka” është edhe **dëgjimi i shpjegimit të lëndëve në auditor** nga Dekani apo Përgjegjësi përkatës i Departamentit.

Universiteti “Epoka” harton në përfundim të çdo viti akademik një **Raport Vetëvlerësimi**, të cilin ia paraqet Këshillit të Lartë të Universitetit.

Gjithashtu, në kuadër të procesit të certifikimit ISO për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, Grupi i Auditit të Brendshëm kryen auditime periodike në çdo njësi akademike dhe administrative të Universitetit si dhe harton **Raportin e Auditit të Brendshëm**, të cilin e ndan me Rektoratin dhe njësitë përkatëse, me

qëllim plotësimin e mangësive dhe zgjidhjen e problematikave të konstatuara në njësitë përkatëse. Me qëllim sigurimin e ndërgjegjësimit të të gjithë stafit akademik dhe administrativ mbi rëndësinë e përvetësimit të kulturës së cilësisë nga çdo njësi e Universitetit “Epoka”, Grupi i Auditimit të Brendshëm zhvillon në një bazë periodike **seminare informuese dhe trajnuese me stafin e institucionit** në lidhje me përbërësit dhe rëndësinë që mbart sigurimi i cilësisë në përgjithësi dhe Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë në veçanti. Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti jepen në Tabelën Aneksi 4)

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Rregullorja e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Raporti vjetor i sigurimit të cilësisë, formularët e vlerësimit, Lista e anëtarëve të NjSBC (tabela 4 në Aneksin 4 bashkangjitur këtij Raporti).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe</p>	<p>Universiteti “Epoka”, ka pjesë të strategjisë së tij përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësim-nxënies, dhe për këtë arsye mbi baza vjetore bëhet vlerësimi i ecurisë së programeve, nëpërmjet shqyrtimit të anketimeve prej studentëve, mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët, sugjerimeve prej pedagogëve të përfshirë në këtë program, etj.</p> <p>Universiteti “Epoka” harton në përfundim të çdo viti akademik një Raport Vetëvlerësimi, të cilin ia paraqet Këshillit të Lartë të Universitetit.</p> <p>Me përfundimin e plotësimit të pyetësorëve, sistemi elektronik nxjerr mesataren e vlerësimit për çdo pedagog lënde me një shifër të përgjithshme si dhe shifër për çdo përbërës të pyetësorit,</p>

rezultatet që synon të arrijë;

Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:

Të tërthorta:

- a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;
- b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;
- c. Pyetje konceptuale;
- d. Intervista;
- e. Etj.

Të drejtpërdrejta:

- a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);
- b. Dëgjime në auditor;
- c. Vlerësimi me nota/pikë;
- d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;
- e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- g. Etj.

duke treguar renditjen e pedagogut të asaj lënde në rang departamenti dhe fakulteti.

Rezultatet finale të përfituara prej pyetësorëve bëhen publike, duke ja komunikuar stafit, studentëve, administratës si dhe më gjerë.

Të dhënat e rezultatet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore të NJBSC nga njëra anë dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik.

Njëkohësisht, në përfundim të çdo semestri akademik, KVAZHC kryen një analizë sasiore dhe cilësore të rezultateve të studentëve dhe del me rekomandimet përkatëse, me një theks të veçantë në evidentimin e problematikave dhe të fushave që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Nga vizita në NJBSC, u vunë në dispozicion të grupit të vlerësimit të jashtëm, sondazhe të studentëve të bëra gjatë viteve akademike, sipas cikleve të studimit dhe pedagogëve të vlerësuar.

Për kryerjen e vlerësimit përdoren metoda të shumëllojshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Këtu përfshihen sondazhet, pjesëmarrje në mbrojtjen e tezave, ndjekjen e ecurisë së studentëve, punësimin, opinionet e tyre mbi rezultatet e të nxëniet dhe orientimit në tregun e punës, ecurinë e praktikave mësimore, etj.

Nga GVJ ju kërkua përgjegjësit të Departamentit dokumentacioni lidhur me vlerësimin e studentëve dhe metodat që përdoren për kontrollin e mësim-nxënies.

U njohëm me proces verbalet e rezultateve, temat e kursit për çdo lëndë, evidentimin e pjesëmarrjes në seancat mësimore dhe mënyrën e vlerësimit nga pedagogët. Pjesëmarrja në seancat mësimore ishte e detyruar.

Vlerësimi i studentëve bëhej sipas disa rubrikave, pjesëmarrjes dhe aktivizimit në klasë, detyrat e shtëpisë, temat e kursit

	<p>dhe diskutimi i shembujve studimorë. Me kënaqësi konstatojmë se rezultatet e studentëve ishin të kënaqshme.</p> <p>Nga bisedat me studentët konstatojmë se ata ishin shumë të kënaqur me metodën e përdorur të mësimdhënies. Nga ana tjetër ata deklaruan se kanë marrë njohuritë e nevojshme, që përputheshin me pritjet e tyre.</p> <p>Në mbarim të studimeve, studentët i nënshtroheshin një provimit formues, ku përfshihen një pjesë e mirë e njohurive që studenti ka marrë gjatë viteve të shkollimit.</p> <p>Metodat e drejtpërdrejta të përdorura janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Vlerësimi për pjesëmarrjen dhe aktivizimin në leksione dhe seminare; b. Dëgjime në auditor. c. Vlerësimi për detyrë dhe/ose temën e kursit; d. Vlerësimi për provimet e pjeseshme; e. Vlerësimi për provimin përfundimtar; f. Vlerësimi me pikë dhe notë.
--	---

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p>	<p>Universiteti "Epoka" ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programit të studimit.</p> <p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë operon në nivel universiteti dhe drejton të gjithë procesin e vazhdueshëm të vetëvlerësimit, raportimit të rezultateve, ndjekjes së reagimit ndaj tyre me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm. Sigurimi i cilësisë në programin Administrim Biznesi, ashtu si dhe në programet e tjera që ofron institucioni realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe NJBSC,</p>
--	--

<p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>tërheqjes së mendimit të studentëve, të stafit akademik, etj.</p> <p>Nga kompetencat e KVAZHC është zhvillimi i strategjive dhe i planeve vlerësuese për personelin akademik. Siç u përmend edhe në pjesën përshkrimore, në fund të çdo viti akademik bëhet edhe vlerësimi për secilin anëtar të stafit akademik, rezultati i së cilit dorëzohet nëpërmjet një zarfi të mbyllur.</p> <p>Universiteti “Epoka” përdor një shumëllojshmëri instrumentesh (formularë vlerësimi, analiza periodike, grupe pune ad hoc si dhe specialistë të fushës, të brendshëm dhe të jashtëm për shqyrtimin dhe miratimin si dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të ofruara.</p> <p>Për të ndërgjegjësuar personelin dhe studentët për rëndësinë cilësisë janë vënë në dispozicion të studentëve dhe të stafit Guida Studentore dhe Guida e Stafit, ku shprehet qartë rëndësia e cilësisë dhe siguri i saj në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Përkrah kësaj, janë organizuar edhe disa trajnime periodike për stafin si dhe këshillimi i vazhdueshëm i studentëve nga këshilltarët e tyre akademikë.</p> <p>Universiteti “Epoka” ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar në planin strategjik të institucionit.</p>
--	--

Konkluzione të GVJ:

Gjatë vizitave në ambientet e Universitetit “Epoka”, u konstatua se Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve. NJBSC ka një status institucional të mirëpërcaktuar, është njësi permanente e mbështetur në anëtarë të brendshëm, më autonominë dhe përgjegjësinë e duhur për të kryer aktivitetin e kontrollit, monitorimit dhe raportimit për cilësinë e brendshme në vazhdimësi të institucionit. Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.

Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve, nëpërmjet instrumenteve matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve. Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm. Institucioni

ka një strategji zhvillimi dhe mision, vizion dhe objektiva të qarta. Mbështetur në strategjinë janë hartuar politikat e zhvillimit.

E gjithë veprimtaria e Institucionit përputhet me vizionin dhe udhëhiqet nga objektivat e strategjisë.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Departamenti i Administrim Biznesit në Universitetin “Epoka” është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Në pajtim me Ligjin mbi Arsimin e Lartë, si dhe udhëzimet dhe urdhrat përkatëse, Universitetit u pajis me licencën në mars 2008. Departamenti i Administrim Biznesit vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e administrim biznesit. Misioni i departamentit është si më poshtë:

Të zhvillojë aftësitë e biznesit përmes metodave holistike të të mësuarit duke bërë të mundur kultivimin e sensit të intelektualizmit, bashkimit dhe udhëheqjes (leadershipit) gjithëpërfshirës. Qëllimi final është që të edukohen profesionistë të gatshëm për tregun për të bashkë-krijuar vlerë midis aktorëve të tregut në kontekstin e punësimit, përmirësimit të vazhdueshëm si dhe qëndrueshmërisë së sistemit të biznesit.

Pasi u konsultua me rregulloren e Programit dhe bisedat me studentët, GVJ konstaton se në përfundim të këtij programi studimi, studentët do të jenë të aftë të:

1. Të kuptojnë, analizojnë, shpjegojnë dhe përdorin konceptet bazë të Administrimit të Biznesit;
2. Të përfitojnë aftësi praktike për të kuptuar kërkesat e dizajnit të një njësie ose mjedisi biznesi
3. Të menaxhojnë funksionet e një dhe funksionet e saj si marketingu dhe prodhimi, por edhe kontabiliteti dhe financat.
4. Të përdorin metodat matematikore dhe statistikore në menaxhimin e biznesit
5. Të aftësohen të komunikojnë përmes marrjes së terminologjisë profesionale të administrimit të biznesit;
6. Të adoptohen me përgjegjësitë etike, sociale dhe ligjore të nevojitur në fushën e administrimit dhe menaxhimit të biznesit;

7. Të aftësohen në përdorimin efektiv të sistemeve të TIK-ut dhe metodave moderne në menaxhimin e biznesit;

Në përputhje me vetë objektivat e programit, për një mësimdhënie që nxit mendimin kritik e krijues të studentit, një nga format më të rëndësishme të mësimdhënies ishte ajo interaktive me në qendër studentin, i cili konsiderohet jo vetëm riprodhues i fakteve ose njohurive që lektori transmeton, por një individ i pavarur për të prodhuar informacione të reja dhe përdorur këto njohuri në mënyrë produktive. Lektorët e universitetit "Epoka" realizojnë mësimdhënie efektive me praktikë të vazhdueshme, duke u bazuar në realitetin vendas, krahasuar atë me sistemet më efektive të botës. Planet mësimore dhe silabuset përkatëse të programit janë bashkëngjitur në tabelën aneks 8.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Ky program studimi ka si objektiv parësor përgatitjen e liderëve të ardhshëm në fushën e menaxhimit të biznesit, duke u përfshirë në një mësimdhënie dhe zhvillim profesional që perfeksionon praktikën e lidërshiptit në arsim, në mënyrë që të përmbushë nevojat e tregut të punës me individë të kualifikuar në fushat respektive. Duke patur parasysh përpjekjet e mëdha për integrimin e Shqipërisë në strukturat perëndimore, kërkesat e tregut të punës për individë të kualifikuar konsiderohen të larta. Parashikuar në Rregulloren e Studimeve Universitare dhe Provimeve të Universitetit "Epoka", programi në fjalë organizohet sipas sistemit me kohë të plotë.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit realizohet me 180 ECTS, në përputhje me planin mësimor të propozuar nga Departamenti i Administrim Biznesit, me vendim të Bordit të Fakultetit dhe miratuar me vendim të Senatit Akademik të Universitetit "Epoka".

1. 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve.
2. 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve.
3. 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit.
4. 1 orë mësimore = 60 minuta.
5. Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë pune.
6. Një vit akademik ka 60 ECTS.

Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Programi i studimit Administrim Biznesi përmban 30 lëndë të ndara në grup lëndësh: lëndë të formimit të përgjithshëm dhe lëndë karakterizuese. Gjatë hartimit të planeve dhe programeve mësimore është mbajtur parasysh raporti midis formave të ndryshme të veprimtarive formuese. Kështu rreth 20% e tyre janë në veprimtari të formimit të përgjithshëm bazë, përkundrajt 78% në disiplina karakterizuese që lidhen me fushën, si edhe veprimtari formuese integrale, praktike, aftësi informatike dhe formime të tjera. Programi i studimit ruan një balancë të caktuar gjatë ndarjes së lëndëve bazuar në veprimtarinë e tyre formuese. E shprehur ndryshe 180 kredite që programi përmban janë të grupuara si më poshtë:

A) Veprimtari formuese	36 kredite
B) Disiplina karakterizuese	83 kredite
C) Lëndë të ngjashme me disiplinat karakterizuese	16 kredite
D) Lëndë me zgjedhje	24 kredite
E) Njohuri të tjera formuese	16 kredite
F) Teza/Provimi diplomës	5 kredite

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi

- Për leksionet 1856 orë në auditor dhe 2544 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 64 orë në auditor dhe 36 orë punë e pavarur e studentit
- Për Laboratorët 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën lëndore 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 2 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licencuara.

Gjatë vizitës në institucion u verifikuan dokumentet e pasqyruara nga RVB dhe u konstatua se nuk kishte asnjë ndryshim midis raportimit dhe faktit (tabela aneksi 5).

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës jepen në tabelën aneksi 6.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset e Programit të Studimit për secilin modul ndodheshin në Sekretarinë Mësimore si dhe mund të aksesoheshin elektronikisht nëpërmjet Sistemit Elektronik. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm studioi çdo syllabus, për secilën nga lëndët e programit. Syllabuset ishin hartuar sipas një forme template të ofruar nga departamenti, dhe përmbanin të gjitha rubrikat e një syllabusi qëllimi dhe objektivat e lëndës, programi i lëndës, mënyra e vlerësimit të studentit, detyrimet dhe të drejtat e studentit, Viti/semestri kur zhvillohet lënda, emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës, çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, format e vlerësimit të studentëve, literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

U shqyrtuan dhe kontrolluan: syllabuset e lëndëve, programet e lëndëve, ngarkesa mësimore e çdo pedagogu, mënyra e hedhjes së rezultateve në mënyrë elektronike, regjistri themeltar, regjistrat e notave, etj. Gjatë vizitës në institucion u shqyrtuan dokumentet e pasqyruara nga RVB dhe u konstatua se nuk kishte asnjë ndryshim midis raportimit dhe faktit. (tabela 5 dhe 6 në Aneksin 5/6 bashkangjitur këtij Raporti)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në “Administrim Biznesi” që ofron Institucioni, është i akredituar, me Urdhërin Nr 260, datë 07.06.2011, si <i>Bachelor në Administrim Biznesi (me kohëzgjatje normale 4 vite akademike)</i> Ky program studimi është riorganizuar nga Bsc (4 vjeçar) në Bsc (3 vjeçar) me Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012 mbështetur në (VKA Nr. 342, datë 13.07.2012)</p> <p>Programi i studimit Bsc në Administrim Biznesi, është organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ndarja e lëndëve/ moduleve sipas veprimtarive formuese është bazuar në Udhëzimin nr 15, date 04,04,2008 të MASH, “Për organizimin e studimeve në IPAL” si dhe në udhëzimin nr.11, date</p>

28,02.2011 të MASH, "Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e në Institucioni privat të arsimit të lartë.

Programi i studimit Bsc në Administrim Biznesi, realizohet në 3 vite studimi/6 semestra, me 180 ECTS në total, ku çdo vit ka 60 kredite

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.

Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;

Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

Departamenti i Administrim Biznesit dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, si njësi kryesore ku Programi Bachelor në Administrim Biznesi bën pjesë, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara jep në faqen e internetit të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit që ofron. Informacioni mund të merret edhe nga sekretaria mësimore dhe sekretaria e Departamentit.

Departamenti publikon në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit që ofron. Ky informacion përmban edhe listën e të gjitha lëndëve të detyruara dhe me zgjedhje për çdo semestër, shoqëruar edhe me silabusin e detajuar për çdo lëndë. Informacioni në fjalë mund të përfitohet gjithashtu nga sekretaria mësimore dhe sekretaria e Departamentit.

Departamenti informon studentët për orët mësimore, frekuentimin, etj. Gjithashtu çdo pedagog orën e parë të mësimi prezanton syllabusin, detyrimet afatet e shlyerjes së detyrimeve.

Departamenti i Administrim Biznesit, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara publikon në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit që ofron, përfshirë edhe silabuset e detajuara për çdo lëndë.

Konkluzionet e GVJ:

GVJ konkludon se njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi jep informacionin e nevojshëm për studentët dhe të interesuarit e tjerë për programin përkatës. GVJ konstatoi se njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit, disponon dokumentacionin e nevojshëm për informim (program studimi, plan mësimor, syllabuse lëndore, etj.) në formë elektronike dhe të printuar. Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese. Universiteti "Epoka" ofron programe të akredituara të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. Studimet organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Ky program studimi është riorganizuar nga Bsc (4 vjeçar) në Bsc (3 vjeçar) me Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012 mbështetur në VKA Nr. 342, datë 13.07.2012. Kjo është hera e parë e akreditimit pas riorganizimit të Programit të studimit.

Programi i studimit "Bachelor" në Administrim Biznes realizohet me 180 kredite. ka kohëzgjatje 3 vite akademike. Kohëzgjatja dhe numri i krediteve është në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, " Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Cilësia e kurrikulave, plani mësimor, syllabuset, metodat e mësimdhënies e mësim-nxënies janë sipas kërkesave të standardeve akademike.

GVJ konstaton se programi në fjalë i përmbush kriteret e kërkuara.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

GVJ konstatoi se metodat dhe teknikat e mësimdhënies që aplikohen e përdoren për programet e studimit të ciklit të parë "Administrim Biznesi" janë të shumëllojshme. Krahas formave të mirënjohura të mësimdhënies një drejtimore (nga pedagogu tek studenti), këto metoda tentojnë drejt formave të mësimimit me pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe strukturimin e ideve të tyre me kontributin e përbashkët pedagog-student. Sipas këtyre metodave, pedagogu është në klasë, jo vetëm në rolin e lektorit, por edhe të një moderatori dhe lehtësuesi të kalimit të dijeve dhe nxitjes së ideve të reja nga ana e studentëve. Disa nga metodat e mësimdhënies që janë përdorur në lëndë të ndryshme, në varësi edhe të natyrës dhe objektivave të formimit janë: *Punë në grup, Prezantimet të rasteve nga praktika, diskutim mbi artikujt në revista biznesi, organizimi i lektoriumeve me figura të njohura të fushës, etj.* Studentët bëhen, gjithashtu, pjesë e projekteve të Universitetit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione 1856

• Seminare	64
• Ushtrime	0
• Laboratorë	0
• Praktikë lëndore	0
• Praktikë profesionale	0
• Etj	0

TOTALI 1920 orë

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimi përcaktohet në syllabusin e secilës lëndë. Këto forma janë të miratuara nga Departamenti, dhe Senati Akademik dhe iu bëhen të njohura studentëve nëpërmjet planit mësimor. Këto forma mund të ndryshojnë me propozim të titullarit të lëndës/modulit, por ato duhet të bëhen përpara se të fillojë semestri dhe duhet të reflektohen në syllabuset e moduleve. Format e kontrollit të dijeve janë: pjesëmarrja dhe aktivizimi në leksione dhe seminare, plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit), testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Në bisedat me stafin dhe studentët, GVJ konstatoi se studentët angazhoheshin në aktivitete të ndryshme, në shërbim të vënies në praktikë të njohurive të marra në auditore dhe ardhjes në ndihmë Universitetit. Disa nga aktivitetet janë: Trajnim studentor ne ambientet e bizneseve, konferenca studentore, konkurse, takime akademike, forume të hapura kombëtare dhe ndërkombëtare, seminare 360 gradë, workshope, turne, etj.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

GVJ nga takimet me studentët, stafin akademik, stafin mbështetës dhe drejtues, konstatoi se, Universiteti "Epoka" ka në strategjinë e vet, fokusin tek tërheqja e studentëve cilësore drejt programeve të saj, dhe këtë strategji e mbështet dhe e bën të mundur nëpërmjet skemave motivuese financuese, mbi bazën e mesatares të niveleve të mëparshme. Pjesë e kësaj strategjie është edhe informimi i studentëve në të gjithë shkollat e mesme të vendit. Ky informim bëhet në periudhat e caktuara nga zyra nëpërmjet programit të Planifikimit të Karrierës. Ky program synon informimin e të gjithë maturanteve në qytete të ndryshme të vendit mbi programet që universiteti ynë ofron, kriteret e pranimit, mundësitë e programit Erasmus, praktikat verore, konferencat, klubet studentore dhe bursat që ne ofrojmë për nxënësit më të mirë.

Pranohen për t'u regjistruar në programin e studimeve te ciklit të parë "Bachelor", shtetasit shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë këto kushte:

1. Vërtetohen me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë shtetit (ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit);
2. Plotësojnë kushtet e tjera të pranimit të përcaktuara në rregulloren e brendshme të Universitetit;
3. Pranojnë pagimin e tarifës së caktuar mujore ose vjetore.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Referuar takimeve në institucion dhe RVB, për pranimin në programin Bachelor në Administrim Biznesi, studentët duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton përfundimin e të paktën një shkolle të mesme si dhe të plotësojnë formularin e aplikimit. Pranohen për të ndjekur studimet universitare edhe kandidatët që vërtetohen me dokumente zyrtare transferimin nga një institucion i arsimit të lartë publik ose jo publik. Studentët që regjistrohen për herë të parë në Universitetin Epoka, i nënshtrohen procedurës së përzgjedhjes. Përzgjedhja bëhet nga një komision i ngritur nga Universiteti. Komisioni, si rregull, bën klasifikimin e kandidatëve, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur si dhe nëpërmjet intervistimit a testimit, kur kjo gjykohet e nevojshme. Gjatë inspektimit të dokumentacionit të studentëve të regjistruar në këtë program studimi nga GVJ, rezultojnë se dokumentacioni i studentëve është i plotë sipas kritereve të deklaruara.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar gjatë vizitës në Institucion dhe raportimin e bërë nga grupi Vlerësimi të brendshëm, në tre vitet e fundit akademike ndjekin studimet 118 studentë me notë mesatare 8.3.

Tabela 1: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi	Viti i regjistrimit	Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)	Nota Mesatare shkolla e mesme (nga 10.00)	Viti i diplomimit sipas kohëzgjatjes normale të studimeve	Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)	Nota mesatare (nga 4.00)
Bsc Administrim Biznesi	2012	25	7.72	2015	11	2.82
Bsc Administrim Biznesi	2013	31	7.73	2016	12	2.88
Bsc Administrim Biznesi	2014	38	8.21	2017	-	-

Handwritten signature

Bsc Administrim Biznesi	2015	40	8.47	2018	-	-
Bsc Administrim Biznesi	2016	40	8.05	2019	-	-

Kalueshmëria e studentëve është rreth 70 përqind.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Nga konsultimi me regjistrat themeltarë, GVJ konstatoi se studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë) për vitet 2016 dhe 2017 ishin 40, me nota mesatare përkatësisht 8.47 dhe 8.05.

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Në Universitetin “Epoka”, studentët vlerësohen sipas një sistemi të bazuar në notën maksimale të barazvlefshme me 4.00. Nota më e ulët kaluese në programet Bachelor, në mënyrë që studentët të vijojnë studimet normalisht është 1.00 nga 4.00. Nota mesatare e studentëve është 2.82 dhe 2,88 përkatësisht për vitin 2012 dhe 2013 (viti i fillimit të studimeve). Numri i studentëve të diplomuar në këtë PS për periudhën 2012 – 2016 është 23 studentë.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Universiteti “Epoka” pranon transferime të studentëve në vitet e ndërmjetme nga shkollat e tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera sipas disa procedurave dhe një dokumentacioni të kërkuar, kjo sipas rregullores së transferimeve. Studentë të sistemit bachelor të transferuar nga universitetet e tjera brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë në universitetin “Epoka” janë 3 në vitin 2012, 1 në 2013, 1 në 2014 dhe 2 në vitin 2015.

- Të dhëna për punësimin e studentëve dhe numrin total të diplomuarve
- Nga bisedat me studentët, pedagogët dhe stafin drejtues të institucionit, konstatoam se zyra e karrierës ishte shumë aktive në informimin dhe gjurmimin e ecurisë së studentëve në tregun e punës. Numri total i të diplomuarve të sistemit bachelor në periudhën 2011 - 2016 është 84, nga të cilët të punësuar në përputhje me diplomën është 38, jo në përputhje me diplomën 18 studentë. 16 studentë vazhdojnë studimet e ciklit të dytë dhe të tretë dhe për 12 studentë nuk ka informacion për punësimin.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<p>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</p> <p>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</p>	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi dhe regjistrimi i kandidatëve në programin e ciklit të parë të studimit BSc në Administrim Biznesi në Universitetin “Epoka” kryhet sipas udhëzimeve të MAS, në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Universiteti “Epoka”, në faqen zyrtare në internet dhe në broshurat që na u vunë në dispozicion kishte shpallur këto kritere të pranimit:</p> <p>Për shtetasit e Republikës së Shqipërisë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të ketë mesatare të Përgjithshme të Shkollës së Mesme mbi 7.00 për të gjitha programet e ofruara në gjuhën Angleze dhe mbi 6.00 në programin e ofruar në gjuhën Shqipe 2. Pikët e Provimit të Maturës Shtetërore (pikët minimale bëhen të ditura çdo vit pas publikimit të rezultateve të Provimit të Maturës Shtetërore) 3. Të ketë mjaftueshmëri të gjuhës Angleze të vërtetuar nëpërmjet një nga certifikatave të njohjes së gjuhës angleze nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë. <p>Për shtetasit e huaj:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të ketë mesatare të Përgjithshme të Shkollës së Mesme mbi 7.00 ose të barasvlershme. 2. Të ketë pikë të mjaftueshme nga provimet përzgjedhëse që organizon shteti përkatës për pranim në ciklin e studimeve të barasvlershëm me ciklin e parë të studimeve të sistemit arsimor universitar të Republikës së Shqipërisë. 3. Të ketë mjaftueshmëri të gjuhës Angleze të vërtetuar nëpërmjet një nga certifikatave të njohjes së gjuhës angleze nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë e detyrueshme në nivelin B1 e sipër. 4. Duhet të ketë njehsimin e diplomës nga Ministria e Arsimit dhe Sportit <p>Mësimi në universitetin “Epoka” zhvillohet në gjuhën angleze.</p>

Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;

Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;

Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;

Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.

Referuar bisedave me stafin dhe studentët, në javën e parë të vitit shkollor studentët informohen në faqen e internetit me të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit që ofrohen nga Universiteti, mënyrën e organizimit të tyre si dhe kohëzgjatjen e programeve të studimit. Përveç kësaj, në mënyrë të vazhdueshme, zyra e karrierës dhe departamenti përkatës informojnë studentët dhe njihen me problemet e tyre. Në fillim të çdo viti akademik institucioni pajis çdo student me Udhëzuesin (Guidën) e Studentit e cila përmban informacionin e nevojshëm për jetën studentore. Në javën e parë të vitit akademik institucioni zhvillon javën e orientimit ku studentët janë të detyruar të ndjekin katër seksione gjatë të cilave informohen në mënyrë të detajuar.

Nga Grupi i vlerësimit të Cilësisë, gjatë vizitës në institucion, na u vunë në dispozicion formularët e vlerësimit që plotësoheshin nga studentët për vlerësimin e pedagogut. Vlerësimi bëhej për çdo pedagog.

Pranë Institucionit ishte ngritur "Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar". Zyra e këshillimit të karrierës ishte aktive, dhe ofronte shërbimin e këshillimit për karrierën të studentëve.

Zyra kryen aktivitete të ndryshme në kuadër të zhvillimit të karrierës së studentëve, si: Panairët e Punësimit, që është një aktivitet i përvitshëm në universitet, si dhe programet e Seminareve të Karrierës në bashkëpunim me kompani të ndryshme. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar u ofron studentëve mundësinë e kryerjes së praktikave profesionale në kompani të ndryshme në përputhje me profilin e studentëve.

Nëpërmjet "Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar" universiteti informon të diplomuarit mbi mundësitë e punësimit gjithashtu edhe për vendet vakante që kanë kompani të ndryshme. Në këtë institucion është mjaft aktiv edhe alumni.

Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se Universiteti “Epoka” ka statistika për numrin e të diplomuarve. Këto të dhëna raportohen çdo vit pranë Drejtorisë së statistikave në MAS (ish MASH). Ndërkohë të dhënat e të diplomuarve mbahen në regjistrin përkatës.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p>	<p>Universiteti “Epoka” mban statistika vjetore të rregullta për numrin e të regjistruarve në programin e ciklit të parë të studimit. GVJ ju vendosen në dispozicion statistika rreth studenteve të regjistruar në vite dhe ecurisë së tyre.</p>
<p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Universiteti “Epoka” disponon në formë elektronike dhe të shkruar, të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit studimor që nga pranimi deri në prag të diplomimit, dokumentacion ky që u verifikua edhe nga GVJ gjatë vizitës inspektuese në institucion. Regjistri i Notave dhe Amza janë dokumentet bazë që pasqyrojnë këto kërkesa.</p>

Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka ngritur një strukturë të veçantë për Këshillimin e Karrierës, që ofron shërbimin e këshillimit për studentët. Progresi i tyre ndiqet dhe ndihmohet nga departamenti përkatës, i cili bashkëpunon me sekretarinë mësimore për të siguruar informacionin e nevojshëm. Krahas kësaj institucioni ka ngritur sistemin e tutoriatit ku çdo grup mësimor, ndiqet dhe asistohet nga një pedagog (bazuar në urdhrat e Rektorit për ngritjen dhe funksionimin e Tutoriatit).</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës është një njësi aktive që funksionon brenda strukturës së Institucionit. Studentët shprehën kënaqësinë e tyre për asistencën e kësaj zyre.</p>

Konkluzionet e GVJ

Gjatë inspektimit të dokumentacionit të studentëve të regjistruar në këtë program studimi nga GVJ, rezultojnë se dokumentacioni i studentëve është i plotë sipas kriterëve të deklaruara. Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj. Ai informon studentët në lidhje me politikat e punësimit, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë dhe angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Në ndihmë të studentëve, Universiteti “Epoka” ka krijuar një rrjet të gjerë

bashkëpunimi me institucione të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, duke u ofruar mundësi praktike verore profesionale studentëve në kompanitë përkatëse.

Departamenti i Administrim Biznesit, në bashkëpunim me Qendrën për Këshillimin e Karrierës i ka ndihmuar studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, duke dërguar kërkesa të veçanta për çdo institucion brenda dhe jashtë vendit.

Studentët e regjistruar janë cilësorë dhe me mestare të lartë.

Nga bisedat me studentët, ata mendonin se universiteti ka imazh publik të lartë; kjo reflektohet në nivelin e studentëve të pranuar dhe në punësimin e studentëve që diplomohen.

Megjithatë, përdorimi i anglishtes në auditore mund të krijojë vështirësi në njohjen e termave profesionale në shqip. Nga ana tjetër, një pjesë e studentëve nuk kanë nivelin e mjaftueshëm të anglishtes.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Universiteti inkurajon të gjithë anëtarët e stafit akademik për të qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ofruar mbështetje financiare. Në përfundim të çdo viti akademik, të gjitha publikimet shkencore të botuara nga ana e stafit akademik vlerësohen nga një juri e posaçme në bazë të kriterëve të përcaktuara në “Rregulloren për Nxitjen e Publikimeve Shkencore” të Universitetit, duke u mbështetur në kriteret përkatëse. Çdo vit, Bordi Administrativ i Universitetit vendos masën e shpërblimit për çdo pikë të fituar dhe në bazë të pikëve të mbledhura, çdo anëtar i stafit akademik përfiton shpërblimin përkatës.

Universiteti “Epoka” ofron gjithashtu mbështetje financiare për pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe veprimtari shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Si rregull, çdo anëtar i stafit akademik ka të drejtë të përfitojë një herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto veprimtari.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

Në bazë të bisedave dhe dokumenteve të vëna në dispozicion nga Institucioni, rezultoi se janë realizuar studime mbi qeverisjen e korporatave, zbatimin e novacionit teknologjik, studime mbi tregun e brendshëm, inteligjencën artificiale,

e-biznes, zhvillimin e qëndrueshëm; çështjet ekonomike dhe monetare; rininë, edukimin dhe formimin profesional; punësimin dhe çështjet sociale; ndërmarrjet; mjedisin; të drejtat e njeriut; marrëdhëniet institucionale; politikat dhe zhvillimet rajonale; dhe zhvillimi rural.

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Nga personeli akademik i IAL, për periudhën 2015-2016 janë botuar 27 libra dhe 36 botime shkencore. Gjithsej për 5 vjetët e fundit, numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i Fakultetit është 186.

<input checked="" type="checkbox"/> Numri i projekteve kërkimore të fituara	15
<input checked="" type="checkbox"/> Numri i projekteve të zbatuara	8
<input checked="" type="checkbox"/> Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	9
<input checked="" type="checkbox"/> Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL	85
<input checked="" type="checkbox"/> Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	-
<input checked="" type="checkbox"/> Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	4
<input checked="" type="checkbox"/> Numri i Çmimeve Kombëtare	6
<input checked="" type="checkbox"/> Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave	

Gjatë vizitave në Institucion, GVJ ju vunë në dispozicion botimet, materiale që dëshmonin kërkimet shkencore, proceedings të konferencave, revista ku ishin botuar artikujt shkencorë, etj.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkimore

Nga vizitat inspektuese në IAL, rezultoi se ky institucion, ka vendosur marrëdhënie me shumë institucione dhe shoqëri tregtare private, si prioritet i lidhjes së teorisë me praktikën, prioritet i shprehur në misionin e tij, dhe që merr zbatim nëpërmjet zbatimit të kontratave. Në Universitetin "Epoka" angazhimi akademik është i lidhur ngushtë me bashkëpunimin ndërkombëtar.

Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (IRO) kryen funksionin e saj nën varësinë e Rektoratit në Universitetin "Epoka". Funksioni i saj kryesorë është zhvillimi dhe zbatimi i politikave ndërkombëtare dhe promovimi i procesit të ndërkombëtarizimit të Universitetit. Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare nxit dhe siguron materializimin e politikave ndërkombëtare të Universitetit në

përputhje me objektivat dhe udhëzimet të vendosura nga Rektoratit në konsultim me partnerët e fakulteteve përkatëse.

Në kuadër të qëllimeve të sipërpërmendura, Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare realizon koordinimin e marrëdhënieve me institucionet e tjera, prezantimin dhe promovimin e Universitetit në arenën ndërkombëtare dhe promovon imazhin ndërkombëtar si një qendër globale e përsosmërisë në mësimdhënie dhe në aktivitetet kërkimore. GVJ konstatoi se një nga vlerat themelore të Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare është përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimit ndaj studentëve, personelit dhe partnerëve me qëllim pasurimin çdo ditë të dimensionit ndërkombëtarë dhe vizibilitetit të Universitetit "Epoka".

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare 11
 - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (5 vitet e fundit) 15
 - Numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit 7
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL (3 vitet e fundit) 6
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor (laboratorë) 2
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime 277

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
 - Institucionet akademike bashkëpunuese 138
 - Organizatat Profesionale 26
 - Komuniteti i biznesit, tregu i punës 36

Dokumentacioni përkatës

Kopje të botimeve shkencore, dokumentacioni i projekteve, memorandumet e mirëkuptimit më universitete partnere, statutet e qendrave të kërkimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
----------------------------	---------------------------------

**VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI,
TË BRENDSHME DHE TË JASHTME**

Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.

Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;

Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

GVJ, mbështetur ne takimet me stafin dhe studentët, si dhe në dokumentat e statutit dhe strategjisë së zhvillimit konstatoi se Departamenti “Administrim Biznesit, inkurajon bashkëpunimin e stafit dhe pedagogëve nëpërmjet aktiviteteve shkencore si projekte, konferenca dhe leksione të hapura.

Departamenti ka hartuar një Rregullore të Organizmit Administrativ, ku ndahen detyrat dhe përgjegjësitë e secilit dhe në të njejtën kohë mundëson bashkëpunimin e stafit dhe studentëve në realizimin e detyrave të përbashkëta.

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një

Nga vizitat inspektuese në IAL, rezultoi se ky institucion, ka vendosur marrëdhënie me shumë institucione dhe shoqëri tregtare private, si prioritet i lidhjes së teorisë me praktikën, prioritet i shprehur në misionin e tij, dhe që merr zbatim nëpërmjet zbatimit të kontratave.

Nga stafi përgjegjës u pohua se në verën e vitit 2016, 64 kompani dhe institucione që operojnë në tregun vendas ishin të gatshme që të përfshinin studentët në programin e praktikave profesionale. Gjithashtu është rënë dakord me kompanitë në fjalë që për çdo praktikant të ketë një mbikëqyrës i cili do të ndjekë vijimësinë e praktikës së studentit. Pas përfundimit të praktikës kompania apo institucioni ku studenti ka kryer praktikën bën një vlerësim të praktikantit.

IAL ka marrëdhënie bashkëpunimi me biznese brenda vendit, por njëkohësisht edhe partnerë të huaj, të cilët organizojnë lektoriume dhe trajnime për përshtatjen sa me të mire të studentëve më tregun e punës.

Universiteti “Epoka” bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Konkluzionet e GVJ

Universiteti "Epoka" për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj. Institucioni ka bërë pjesë të analizave të tij dhe ecurinë e këtyre marrëveshjeve.

Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj. GVJ gjithashtu arriti dhe në përfundimin se përfshirja e Universiteti "Epoka" në një game të gjerë dhe të larmishme bashkëpunimesh dhe partneritetesh ofron mundësi më të shumta për pjesëmarrjen e personelit dhe studentëve në evente kombëtare dhe ndërkombëtare siç janë konferencat, simpoziumet, konkurset, workshopet, krahas atyre që organizohen nga vetë IAL

Konkludua se në këtë universitet kemi një integrim optimal të mësimin me kërkimin, dhe universiteti është angazhuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Universiteti "Epoka ofron Programin Bachelor "Administrim Biznesi", si program i ciklit të parë të studimeve, brenda Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë. Ky program studimi *synon në edukimin sipas koncepteve moderne të menaxhimit të biznesit*. Programi synon pajisjen e studentëve me njohuri bazë mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme si dhe formimin e aftësive të veçanta në menaxhim të biznesit.

GVJ konkludon se programi i studimit "Administrim Biznesi" është në përputhje me misionin e këtij institucioni si dhe me strategjinë e tij për zhvillim. GVJ konkludon se programi i ofruar është në përputhje me interesat kombëtare dhe me tregun e punës.

Universiteti "Epoka" ndjek një strategji të hapur për bashkëpunim dhe partneritet në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për realizimin e misionit dhe të qëllimit të tij. Me institucionet e huaja arsimore që ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, Universiteti "Epoka" ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve, për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore dhe trajnime profesionale e stazhe studentore. Universiteti "Epoka" siguron mundësi të shumta për kryerjen e praktikave profesionale nga ana e studentëve, veçanërisht gjatë sezonit të verës, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me institucione dhe kompani brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë vizitës në institucion u konstatua se procedurat e rekrutimit janë transparente. Njësia e Burimeve njerëzore disponon një bazë të mirë të dhënash për të gjithë stafin ku gjithsecili ka kontratën përkatëse për punën që zhvillon. Personeli ndihmës (sekretaria) ishte në nivel universiteti dhe në nivel Departamenti.

GVJ konstatoi se mjediset e ofruara janë të përshtatshme për procesin mësimor, administrativ, kërkimor e shkencor të institucionit. Gjithashtu institucioni ofron një bibliotekë për nevojat e studentëve dhe të stafit. Institucioni në mënyrë periodike vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare me anë të Zyrës së Financës. Gjithashtu ai auditohet dhe është nën kontroll të organeve tatimore. Në përputhje të plotë me Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", Nr. 9741, datë 21.05.2007, institucioni ka ngritur një Njësi të Sigurimit të Cilësisë e cila funksionon në bazë të "Rregullores së Njësies së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë" miratuar me vendim të Senatit Akademik. Rregullorja shpreh qartë rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet së cilës garantohet cilësia gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të Universitetit.

Gjatë inspektimit të dokumentacionit të studentëve të regjistruar në këtë program studimi nga GVJ, rezultojnë se dokumentacioni i studentëve është i plotë sipas kriterëve të deklaruara.

Nga vizitat inspektuese në IAL, rezultoi se ky institucion, ka vendosur marrëdhënie me shumë institucione dhe shoqëri tregtare private, si prioritet i lidhjes së teorisë me praktikën, prioritet i shprehur në misionin e tij, dhe që merr zbatim nëpërmjet zbatimit të kontratave. Në Universitetin "Epoka" angazhimi akademik është i lidhur ngushtë me bashkëpunimin ndërkombëtar.

Perfundim:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në Institucion vlerësoj që Universiteti "EPOKA" i ka plotësuar rekomandimet e vendosura në VKA Nr. 176, datë 30.05.2011, për programin e studimit Bsc në "Administrim Biznes".

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a) Pika të forta:

- 1) Manaxhim korrekt me eksperiencë dhe i përkushtuar;
- 2) Cilësia e kurrikulave, plani mësimor, syllabuset, metodat e mësimdhënies e mësim-nxënies janë sipas kërkesave të standardeve akademike;
- 3) Staf akademik me kualifikim dhe përvojë ndërkombëtare;
- 4) Integrim i mësimit me kërkimin;
- 5) Sistemet e informacionit dhe faqja web shumë funksionale dhe mjaft informuese si për stafin aktual ashtu edhe për studentët potencialë;
- 6) Mjedise tepër moderne dhe të përshtatshme për mësimdhënien dhe aktivitetet ndihmëse;
- 7) Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 8) Imazh publik i lartë;
- 9) Bibliotekë me ambiente komode për studim;
- 10) Cilësi e mirë e pjesës më të madhe të studentëve të regjistruar;
- 11) Përdorimi i teknologjisë Informatike në procesin e mësimdhënies.

b) Pika të dobëta:

- 1) Diversitet kulturor i stafit akademik dhe administrativ;
- 2) Mungesa fizike e teksteve mësimore në librari;
- 3) Përdorimi i anglishtes në auditore mund të krijojë vështirësi në njohjen e termave profesionale në shqip;
- 4) Burime të kufizuara financiare;
- 5) Nivel i ulët i njohurisë së gjuhës angleze nga ana e një pjese të studentëve;
- 6) Mungesa e njohjes së gjuhës shqipe nga një pjesë e stafit të huaj lidhur me ndjekjen e rregullt të zhvillimeve sociale, ekonomike dhe politike në vend.

c) Mundësitë:

- 1) Projekte dhe bashkëpunime të reja më aktorë brenda dhe jashtë vendit, për rritjen e reputacionit të programit dhe njohjen lokale dhe ndërkombëtare;

- 2) Tradita e shqiptarëve përse i përket arsimimit – popull arsimdashës – krijojnë shanse për zhvillimin e mëtejshëm të Programit Menaxhim Biznesi;
- 3) Marrëveshjet e shumta me bizneset për realizimin e praktikave dhe mundësi punësimi për studentët;
- 4) Rritja e interesit të shoqërisë në të mësuarin e vazhdueshëm;
- 5) Përmirësimi i imazhit të Universitetit me orientim drejt kërkimit.

d) Pengesat:

- 1) Rritja e globalizimit e shoqëruar me rritje të konkurrencës në tregjet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë;
- 2) Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor, krijojnë problem në përshtatjen e institucioneve arsimore;
- 3) Mungesa e informacionit në tregun e punës lidhur me cilësinë dhe vlefshmërinë e diplomave të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë;
- 4) Tranzicioni i tejzgjatur i ekonomisë shqiptare çon në krijimin e një mjedisi jo shumë të qëndrueshëm dhe transparent;
- 5) Mungesa e indekseve rankuese të certifikuara të universiteteve në rajon dhe në vend;
- 6) Paqartësi e publikut të gjerë mbi punën dhe profesionin e menaxherit, ekonomistit dhe financierit;
- 7) Niveli i lartë i papunësisë;
- 8) Mungesa e ndërgjegjësimit të sipërmarrjeve shqiptare për relacione institucionale me universitetet.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Vasilika Kume

